



Periodik mujor Nr. 165 Shkurt 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**AMF udhëheq takimet bilaterale në
Bruksel për Kapitullin 9-të “Shërbimet
Financiare”**

03-04

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

Tregu i Sigurimeve, Janar 2023

05

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

06-10

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

11-12

AMF udhëheq takimet bilaterale në Bruksel për Kapitullin 9-të “Shërbimet Financiare”



Bruksel, 13-14 shkurt 2022 – AMF takimet bilaterale për Kapitullin 9-të “Shërbimet financiare”



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kryesoi delegacionin shqiptar që mori pjesë në datat 13-14 shkurt 2022 në takimet bilaterale Shqipëri-BE për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”. Grupi negociator, nën drejtimin e z. Evin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së përbëhej nga përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Takimi u hap nga eksperti i nivelit të lartë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit në KE, Marc Jorna, si edhe nga fjalët përshëndetëse të znj. Majlinda Dhuka, Ministre Shteti dhe Kryenegociatore e Shqipërisë, si edhe drejtuesve të tjerë të drejtorive të Komisionit Evropian, përgjegjës për tregjet financiare.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së u ndal te zhvillimet kryesore të sektorit financiar në Shqipëri, duke theksuar se sektori u paraqit rezistent ndaj efekteve të tërmetit, pandemisë dhe presioneve të fundit inflacioniste. Z. Mete u shpreh se autoritetet ndërmorën një sërë ndryshimesh ligjore e rregullatore pas krizës financiare botërore të vitit 2008, të cilat rezultuan efikase. Gjithashtu, ai përmendi hapat e ndërmarrë nga rregullatorët financiarë në kuadër të përafrimit të mëtejshëm me direktivat evropiane të fushës.

Vijon ...

AMF udhëheq takimet bilaterale në Bruksel për Kapitullin 9-të “Shërbimet Financiare”

... Vijon

Ekspertët e Komisionit Evropian theksuan se ashtu siç është nënvizuar edhe në Progres Raportet e fundit, Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm sa i përket plotësimit të rekomandimeve dhe përafrimit ligjor e rregullator në Kapitullin 9-të, por mbetet ende punë për t’u bërë. Ata nënvizuan se Kapitulli 9-të ka rëndësi të posaçme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Gjithashtu ekspertët e KE-së shprehën mbështetje të plotë për Shqipërinë në procesin e reformave dhe të përafrimit të *acquis* në fushën e shërbimeve financiare.

Anëtarët e grupit negociator përgjatë dy ditëve të takimeve bilaterale prezantuan në mënyrë të detajuar nivelin e përafrimit me direktivat evropiane të fushës, si edhe adresuan pyetjet e ngritura nga ekspertët e Komisionit Evropian. *Acquis* në Kapitullin 9-të rregullon shërbimet financiare në fushën bankare, atë të sigurimeve, pensioneve vullnetare, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të titujve.

Përgjatë viteve të fundit është realizuar një avancim domethënës ligjor e rregullator sa i përket shërbimeve financiare, duke u përafuar me direktivat evropiane të fushës. Në vitin 2020 u miratuan ligjet e reja për tregjet e kapitalit, sipërmarrjet e investimeve kolektive, si edhe për tregjet financiare të bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë. Ndërsa në vitin 2021 u miratua ligji i ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit. Projektligji i ri për fondet e pensioneve private është në pritje të miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë.

Raporti I Progresit 2022:
“... Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm sa i përket plotësimit të rekomandimeve dhe përafrimit ligjor e rregullator në Kapitullin 9 ...”

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar 2023 kapën vlerën 1,712 milionë lekë, ose 20.6% më shumë se në janar 2022. Gjatë muajit janar 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 96,527 me një rritje prej 15.19% krahasuar me janar 2022.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.54% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 9.46%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 44.19% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 55.81% të totalit të tregut.

Gjatë muajit janar 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 560 milionë lekë, ose 42.51% më shumë se në periudhën janar 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar 2023 kapën vlerën 350 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 18.09% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë muajit janar 2023 arritën rreth 955 milionë lekë, ose 11.46% më shumë se në periudhën janar 2022.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF zgjeron bashkëpunimin me rregullatorët evropianë, Memorandum Mirëkuptimi me Autoritetin Mbikëqyrës të Luksemburgut (CSSF)



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Komisioni i Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Luksemburgut (CSSF) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy rregullatorëve. Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete dhe Drejtori Ekzekutiv i CSSF-së, z. Claude Marx.

Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve financiarë, sipas fushave ku ata ushtrojnë funksionet mbikëqyrëse, tregun e kapitaleve, tregun e fondeve të investimeve dhe fondet private të pensioneve. Synimi i Memorandumit të Mirëkuptimit është vendosja e urave të bashkëpunimit mes dy autoriteteve mbikëqyrëse, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, promovimit të integritetit, stabilitetit dhe eficiencës në tregjet nën mbikëqyrje përmes konsultimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes dy autoriteteve mbikëqyrëse.

AMF udhëheq negociatat për Kapitullin 9-të “Shërbimet Financiare” dhe në këtë kuadër, zgjerimi i bashkëpunimit me rregullatorët evropiane, përveç shkëmbimit të informacionit, do t’i shërbejë për të përfituar nga eksperiencia dhe asistenca e tyre në funksion të përafrimit me legjislacionin e BE-së, si edhe avancimit drejt praktikave më të mira mbikëqyrëse.

Volume 16 (2023)

Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four quarterly 100-page issues. Articles scheduled for Volume 16 are available to view on the ['Forthcoming content'](#) page.


The papers and case studies included in Volume 16 are listed below:

[Volume 16 Number 1](#)

Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (*Journal of Risk Management in Financial Institutions*) Vëllimi 16, 2023, Numri 1 henrystewartpublications.com

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikujt e mëposhtëm:

- Editorial/Opinion “Përcaktimi i vlerësimit të rrezikut mjedisor dhe social në një bankë shumëpalëshe zhvillimi” - Cristiane Ronza, specialiste kryesore e menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social; Stefanie Brackmann, specialiste kryesore e menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social, Banka Ndër-Amerikane për Zhvillim
- “A duhet të mbështeten investitorët në blerjet e aktiveve të bankës qendrore për tregjet?” - Colin Ellis, Profesor i Financës, Shkolla Ndërkombëtare e Biznesit Hult
- “Dështimi i menaxhimit strategjik të rrezikut në një kompani sigurimi të Jetës në Indi” - Sonjai Kumar, Profesionist i Certifikuar i Menaxhimit të Riskut, IRM dhe Purnima Rao, Profesor i Asociuar, Instituti Fortune i Biznesit Ndërkombëtar
- “Çfarë mund të mësojmë për programet e riblerjes dhe rreziku sistemik? Dëshmi nga bankat amerikane gjatë trazirave financiare” - Foued Hamouda, Asistent Profesor, Instituti i Lartë i Menaxhimit të Tunisit GEF2A-Lab, dhe Instituti i Lartë i Menaxhimit të Gabès
- “Një kuadër ekonomik koherent për të modeluar korrelacionet midis PD, LGD dhe EaD, dhe aplikimet e tij në modelimin EaD dhe SNRF-9” - Peter Miu, Profesor i Financës, DeGroot School of Business, McMaster University; Bogie Ozdemir, Bashkëthemelues, RiskVision
- “Vlerësimi i rreziqeve në investimet ndërkombëtare duke përdorur grupe termash fuzzy ngurrues” - Ayfer Basar, Lektore Vizituese, Universiteti Özyeğin



Revista "Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare"
(*Journal of Risk Management in Financial Institutions*)
Vëllimi 16, (2023) Numri 1
<https://www.henrystewartpublications.com/jrm/v16>

Dështimi i menaxhimit strategjik të rrezikut në një kompani sigurimi të Jetës në Indi

Sonjai Kumar, Profesionist i Certifikuar i Menaxhimit të Riskut, IRM dhe
Purnima Rao, Profesor i Asociuar, Instituti Fortune i Biznesit Ndërkombëtar

Abstrakt

Ky punim diskuton rëndësinë e menaxhimit strategjik të rrezikut, shmangien e një efekti negativ në performancën në sektorin e sigurimeve të Jetës, nëse risqet afatgjata injorohen. Rasti i konsideruar në këtë punim është ngritja dhe më pas rënia e një kompanie sigurimesh Jete në Indi. Kompania filloi shitjen dhe shpërndarjen e produkteve në bashkëpunim me bankat (Bancassurance), por injoroi momentin e tregut, tendencat, shpërndarjen, zhvillimin dhe nuk ndryshoi strategjinë e saj të shpërndarjes. Si rezultat, kompania, e cila luajti një rol pionier në krijimin e modelit të Bankës së Sigurimit, tani po performon dobët, duke qenë në fund të shkallës së të ardhurave të reja nga primet e biznesit.

Fjalë kyçe:

Strategji; menaxhimi i rrezikut; menaxhimi strategjik i riskut; sigurim i Jetës; Banka në Sigurime; shitjes dhe shpërndarjes

IOSCO rishikon Parimet e saj të vitit 2011 për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Tregjeve të Derivateve të Mallrave për të siguruar integritetin e tregut



Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë ka publikuar një version të rishikuar të Parimeve të tij të vitit 2011 për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Tregjeve të Derivateve. Qëllimi i rishikimit është sigurimi që këto Parime të vazhdojnë të ofrojnë një kuadër elastik për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të derivateve.

Parimet pasqyrojnë karakteristikat e tregjeve të derivateve deri në vitin 2011. Ndërkohë këto tregje kanë vazhduar të evoluojnë gjatë dekadës së fundit, të nxitur edhe nga zhvillime të ndryshme të tregut dhe ngjarje ndërkombëtare në formën e ndërprerjeve të jashtme, të tilla si pandemia COVID-19 dhe konflikti Rusi-Ukrainë.

Kryetari i Bordit të IOSCO-s, Jean-Paul Servais, tha: “Ngjarje të ndryshme vitin e kaluar theksuan se si tensionet e vazhdueshme gjeopolitike dhe pasiguria e rritur makroekonomike mund të prishin tregjet globale të mallrave dhe të krijojnë paqëndrueshmëri të konsiderueshme, me efekte të mundshme tronditëse më gjerë në sistemin financiar. Publikuar fillimisht në 2011, si një mandat i G-20, Parimet e IOSCO-s synojnë të sigurojnë integritetin e tregjeve të derivateve të mallrave. Siç tregojnë ngjarjet e fundit, zbatimi i duhur i Parimeve është thelbësor për formimin e çmimeve të shëndetshme në tregjet e derivateve të mallrave dhe në tregjet themelore të energjisë fizike, metaleve dhe ushqimit, të cilat të gjitha janë thelbësore për funksionimin e ekonomisë globale. Të 24 parimet e rishikuara kërkojnë të mbështesin tregjet të derivateve të mallrave në ofrimin e funksioneve të tyre themelore, ndërkohë që funksionojnë pa manipulime dhe skema tregtimi abuzive.

Vijon...

IOSCO rishikon Parimet e saj të vitit 2011 për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Tregjeve të Derivateve të Mallrave për të siguruar integritetin e tregut

Principles for the Regulation and Supervision
of Commodity Derivatives Markets

Final Report



The Board
OF THE
INTERNATIONAL ORGANIZATION OF SECURITIES COMMISSIONS

FR02

JANUARY 2023

... Vijon

Në rishikimin e Parimeve të saj, IOSCO u fokusua në mbikëqyrjen e tregut:

- Transparencë;
- Zbulimi i çmimit;
- Korrelacioni me tregjet fizike;
- Adresimi i tregjeve të çrregulluara; dhe
- Reagimi ndaj abuzimit të tregut.

Parimet në përgjithësi dhe rishikimet e bëra trajtojnë çështje të ndryshme të theksuara më së fundi gjatë trazirave dhe luhatshmërisë së tregjeve të mallrave. Në mënyrë të veçantë, Parimi i ri Nr. 16 mbi “Ndërprerjet e Papritura” synon të drejtojë rregullatorët në rivendosjen e tregjeve të rregullta në rast të një ndërprerjeje të papritur dhe të sigurojë që pjesëmarrësit e tregut të kenë një proces dhe plane të përshtatshme për të adresuar këto ngjarje.

IOSCO beson se autoritetet përkatëse të tregut duhet të rishikojnë politikat dhe rregulloret e tyre për të siguruar që Parimet janë vënë në fuqi.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të tregut të fund vitit të publikuara nga HAIC – Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, tregu grek i sigurimeve arriti në 4.85 miliardë euro në fund të vitit 2022, me një rritje prej 4.2% në terma vjetorë.

Sigurimet e Jo-Jetës realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me 2.41 miliardë euro, duke shënuar një rritje me 6.1% krahasuar me një vit më parë. Ndërsa sigurimet e Jetës realizuan 2.42 miliardë euro prime, duke shënuar një rritje me 2.4% në vit.

KROACI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuar nga Byroja Kroate e Sigurimeve, vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit me bazë në Kroaci u rrit me 8.18% në fund të vitit 2022 krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 12.7 miliardë HRK ose rreth 1.68 miliardë euro. Po kështu edhe vëllimi total i dëmeve bruto të paguara u rrit në 7.71 miliardë HRK nga 7.29 miliardë HRK që ishte një vit më parë.

Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 11.46% në vitin 2022, krahasuar me një vit më parë duke arritur në 9.83 miliardë HRK. Sigurimet e Jo-Jetës përfaqësojnë rreth 77.55% të totalit të tregut. Ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ranë me 1.79% në fund të vitit 2022, duke arritur në 2.84 miliardë HRK.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Këshilli i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve ISA, ka miratuar, ndër të tjera, rregulloren për sistemin e menaxhimit në kompanitë e sigurimit. Rregullorja synon të harmonizojë më tej rregulloret e Malit të Zi me rregulloret e BE-së në fushën e sigurimeve.

Risia më e rëndësishme është përshkrimi i detajuar i sistemit dhe funksionit të menaxhimit të rrezikut, ku ndër të tjera, është detyrimi i një shoqërie, që për të vlerësuar nevojat për kapital, përveç atyre të përcaktuara nga ligji i sigurimeve, të kryejë të paktën një herë në vit një vlerësim të pavarur të rreziqeve të aftësisë paguese.

Këshilli shqyrtoi edhe rezultatet e veprimtarisë së sektorit të sigurimeve në vitin 2022. Ky vit ishte më i miri deri tani, për sa i përket primeve të shkruara bruto, duke tejkaluar rezultatet e vitit rekord 2021. Të dhënat paraprake tregojnë një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 108.3 milionë euro në vitin 2022, që paraqet një rritje prej 9.6% më shumë se një vit më parë.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 10.3% duke arritur në 8.1 milionë euro. Rritje pati edhe tregu i sigurimit të Jetës me 6.8% duke arritur në 1.4 milionë euro. Lloji më i zakonshëm i sigurimit në tregun malazez është sigurimi i përgjegjësisë motorike, që zë 36.6% të totalit të tregut, i ndjekur nga sigurimi i Jetës me 18.1%, sigurimi nga aksidentet me 10.6% dhe sigurimet e tjera të pasurisë që zënë 9.1%.

SERBI

www.xprimm.com

Duke iu referuar informacioneve nga Shoqata e Siguruesve të Serbisë *Association of Insurers of Serbia (UOS)*, primet e shkruara bruto të MTPL-së u rritën me 12% - 15% në varësi të ofruesit të sigurimit për të gjitha kategoritë e automjeteve. Siç raporton shoqata, pas “luftës së çmimeve” në gusht të vitit 2022, kësaj radhe çmimet janë harmonizuar me Bankën Kombëtare të Serbisë.

“Kjo është rritja e parë e çmimeve që nga 1 korriku 2014. Arsyeja kryesore është inflacioni global, i cili ka çuar në rritje drastike të çmimeve të pjesëve të këmbimit të automjeteve, çmimit të shërbimeve për automjetet dhe pjesët e përdorura, të cilat janë përcaktuese në përlogaritjen e dëmit. Përveç kësaj, ka gjithnjë e më shumë automjete hibride, pjesët rezervë të të cilave janë dukshëm më të shtrenjta dhe më të ndjeshme ndaj defekteve, e cila ndikon edhe në çmimin e policës. Këto janë arsyet kryesore pse polica e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve është bërë më të shtrenjtë. Të gjithë këtyre argumenteve u shtohet edhe rritja e çmimeve me pakicë që nga viti 2014” – theksohet në informacionin e Shoqata e Siguruesve të Serbisë.

Sipas ekspertit të sigurisë në trafik, të cituar në materialin e Xprimm, rritja e primeve të MTPL-së do t'i lejojë siguruesit të përballen me kostot e rritura të riparimit, veçanërisht duke pasur parasysh se metoda e llogaritjes së humbjeve, e pandryshuar që nga miratimi rreth 40 vjet më parë, ofron si të dhëna për llogaritjen e dëmshpërblimit të vlerës së makinës dhe çmimit të pjesëve të këmbimit në ditën e dëmtimit.

VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE

www.xprimm.com

Sipas statistikave të sigurimeve të përpunuara nga Xprimm.com, tregu i sigurimeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në fund të shtatorit 2022, arriti në 31.98 miliardë euro, duke shënuar një rritje me 5.37% në terma vjetore. Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara për të njëjtën periudhë u rrit me gati 9% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 18.50 miliardë euro.

Tregu i sigurimeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore përfshin shifrat e tregut të publikuara nga Autoritetet e Sigurimeve dhe Shoqatat Profesionale të Siguruesve në 17 vende.

Për sa i përket vëllimit të primeve të shkruara bruto, tregu më i madh rajonal i sigurimeve ishte Polonia, me 10.82 miliardë euro dhe duke zënë rreth 33.86% të tregut, e ndjekur nga Çekia që zë 19.29% të totalit të tregut dhe Hungaria që zë 8.19%. Për sa i përket ritmeve të rritjes, tregu rumun i sigurimeve shënoi rritjen më të madhe të vëllimit të primeve të shkruara bruto me +23.24%, duke arritur në 2.43 miliardë euro dhe duke zënë 7.62% të tregut në total.

Rënia më e madhe e primeve të shkruara bruto u raportua nga siguruesit sllovakë me -10.55% duke arritur në 1.43 miliardë euro.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al